Në bazë të nenit 26, paragrafi 2, pika 1 në lidhje me nenin 29, paragrafi 7 të Ligjit për veprimtaritë komunale ("Fl. zyr. RMZ", nr. 55/16, 74/16, 02/18 dhe 40/19), nenit 26 dhe 59 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Fl. zyr. MZ", nr. 2/18 dhe 34/19) dhe nenit 58, paragrafi 1, pika 2 të Statutit të Komunës s Ulqinit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. 48/19), Kuvendi i Komunës së Ulqinit, në mbledhjen e mbajtur, më ___. ___. 2019, ka nxjerr

# VENDIMIN
# PËR DHËNIEN E PËLQIMIT NË PLANIN E PUNËS TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "UJËSJELLËSI DHE KANALIZIMI" ULQIN PËR VITIN 2020

## Neni 1

Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Ujësjellës dhe kanalizimi" Ulqin, i jepet pëlqimi në Planin e punës për vitin 2020, nr. 3254, të cilin paraprakisht e ka miratuar Bordi i drejtorëve, në mbledhjen e mbajtur, më 05. 12. 2019.

## Neni 2

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e botimit në "Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës".

Numër: ____________
Ulqin, më ___. ___. 2020

**KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT**
**KRYETARI I KUVENDIT**

Dr. Ilir Çapuni

**A r s y e t i m**

Bazën juridike për nxjerrjen e këtij vendimi për dhënien e pëlqimit e përmban dispozita e nenit 26, paragrafi 1 pika 1 e Ligjit për veprimtaritë komunale (“Fl. zyr. RMZ”, nr. 55/16, 74/16, 02/18 dhe 40/19) me të cilin në mes tjerash është parashikuar që veprimtaritë komunale kryhen në bazë të programit vjetor të kryerjes së veprimtarive komunale, të cilat me propozim të kryesit të veprimtarive komunale i nxjerr Kuvendi i njësisë së vetëqeverisjes lokale deri në fund të vitit në vijim, për vitin e ardhshëm, ndërsa me nenin 29, paragrafi 7 është parashikuar që realizimi i interesit publik bëhet me nxjerrjen e programit vjetor dhe me miratimin e raportit vjetor për kryerjen e veprimtarive komunale në pajtim me nenin 26 të këtij ligji, nenit 25 të Vendimit për themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Ujësjellësi dhe kanalizimi” Ulqin (“Fl. zyr. Mz – dispozitat e komunës”, nr. 31/16 dhe 48/18) dhe nenin 58, paragrafi 1, pika 2 të Statutit të Komunës s Ulqinit (“Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës”, nr. 48/19), me të cilin është parashikuar që Kuvendi i Komunës nxjerr dispozita dhe akte të tjerë të përgjithshëm dhe që në kryerjen e punëve nga kompetencat e veta përveç Statutit, nxjerr vendime, aktvendime dhe akte të tjerë.

Bordi i drejtorëve të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Ujësjellësi dhe kanalizimi” Ulqinnë mbledhjen e mbajtur, më 03. 12. 2019 me vendimin nr. 3254 ka miratuar Planin e punës të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Ujësjellësi dhe kanalizimi” Ulqin.

Duke pasur parasysh që Kuvendi i komunës jep përlqimin në statutet e shërbimeve publike, në ndryshimet statutare, rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit, në Planin e zhvillimit, Programin e punës dhe akteve të tjerë të shërbimeve publike, është konfirmuar propozim vendimi për dhënien e pëlqimit në Programin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Ujësjellësi dhe kanalizimi” Ulqin..

Kështu që me vendimin e propozuar me dispozitën e nenit 1 jepet pëlqimi për Planin e punës të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Ujësjellësi dhe kanalizimi” Ulqin për vitin 2020, nr. 3254, të cilin bordi i drejtorëve e ka nxjerr në mbledhjen e mbajtur, më 05. 12. 2019, kurse me dispozitën e nenit 2 është parashikuar afati i hyrjes në fuqi të vendimit të propozuar ditën e tetë prej ditës së publikimit në “Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës”.

Në bazë të asaj sa u tha i propozohet Kuvendit që të nxjerrë Vendimin për dhënien e pëlqimit në Planin e punës të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Ujësjellësi dhe kanalizimi” Ulqin.

**Përpunues**
Sekretariati për veprimtari komunale dhe mbrojtje të ambientit

**JAVNO PREDUZEĆE “VODOVOD I KANALIZACIJA“ ULCINJ**
**NDERMARRJA PUBLIKE “UJESJELLESI DHE KANALIZIMI“ ULQIN**

# PROGRAMI I PUNËS
# PËR
# VITIN 2020




**Ulqin 2019**

P Ë R M B A J T J A


| | |
|---|---|
| **HYRJE** | **2** |
| **PËRSHKRIMI I SISTEMIT EKZISTUES** | **4** |
| **ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE** | **12** |
| **PROGRAMI I PUNËS SIPAS SEKTORËVE** | **15** |
| **PLANI FINANCIAR I AFARIZIMIT PËR VITIN 2020** | **28** |

# HYRJE

Ndërmarrja publike „Ujësjellësi e kanalizimi" Ulqin fillon nga puna në vitin 2012 në procesin e ndryshimit statusor "Ndërmarrja komunale publike" Ulqin, përmes ndarjes me themelimin e dy ndërmarrjeve publike dhe pushimin e ndërmarrjeve të cilat ndahet.

Si rezultat i kësaj "Ndërmarrja komunale publike" Ulqin është fshirë nga regjistri qendror i Gjykatës ekonomike të Malit të Zi, në bazë të Vendimit të Këshillit drejtues të "Ndërmarrjes komunale publike", nrë 792/1 të datës 21. 03. 2011 dhe Vendimit të Kuvendit të komunës së Ulqinit të datës 31. 10. 2011, të botuar në Fletoren zyrtare të Malit të Zi, dispozitat e komunës, nr. 6 të datës 21. 02. 2012.

Më 21. 03. 2012 në pajtim me Ligjin për shoqëritë ekonomike, si trashëgues ligjorë të "Ndërmarrja komunale publike" Ulqin, në Regjistrin qendror të Gjykatës ekonomike të Malit të Zi, janë regjistruar dy ndërmarrje të reja publike, si:

- Ndërmarrja publike "Ujësjellësi dhe kanalizimi" – Ulqin, me seli në rr. Nëna Terezë pn, Ulqin dhe numrin e regjistrimit 8-0024464 dhe
- Ndërmarrja publike "Veprimtaritë komunale" – Ulqin, me seli në rr. Nëna Terezë pn, Ulqin dhe numrin e regjistrimit 8-0024479.

Themelues i dy ndërmarrjeve të reja publike është Komuna e Ulqinit me pjesëmarrje 100 %.

Ndërmarrja publike "Ujësjellësi e kanalizimi" – Ulqin (UEK), ka shenjat e mëposhtme të regjistrimit:
Numri amzë: 02877449
PIB: 02877449
TVSH numër: 82/31-01330-0
Shifra e veprimtarisë 3600 Grumbullimi, pastrimi dhe distribuimi i ujit.

Organi administrues i UEK-ut Ulqini është Këshilli drejtues, kurse organ udhëheqës është drejtori. Bordi i drejtorëve ka pesë anëtarë. Kryetarin dhe anëtarët e bordit i emëron Themeluesi për një periudhë prej katër vitesh. Drejtorin e ndërmarrjes si një organ udhëheqës e emëron dhe shkarkon Bordi i drejtorëve të UEK-ut. Pajtueshmërinë për emërimin e tij e jep themeluesi. Mandati i drejtorit zgjatën katër vjet.

Kryerja cilësore e punëve për të cilat UEK është regjistruar është në lidhje direkte me ndërtimin dhe pajisjen teknike të sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, sasitë e disponueshme të ujit, pajimin teknik, strukturën kuadrovike, trajnimin dhe organizimin e Ndërmarrjes publike, të cilës i janë dhënë në administrim dhe mirëmbajtje sistemet e përmendura.

UEK Ulqini furnizon me ujë dhe trajton ujërat e zeza në hapësirën e Komunës së Ulqinit, ku janë ekzekutuar instalimet e ujësjellësit publik, e ato janë zonat e Ulqinit, Plazhit të madh, Adë, një pjesë e zonave rurale dhe zona e Anës së Malit. Në vitet e kaluara UEK Ulqin ka investuar angazhime të mëdha në rritjen e cilësisë së prodhimeve dhe shërbimeve.

## PËRSHKRIMI I SISTEMIT EKZISTUES

### Objektet dhe instalimet e sistemeve të ujësjellësit

Në territorin e Ulqinit ekzistojnë tre sisteme të ujësjellësit:

- Sistemi i ujësjellësit "Ulqini"
- Sistemi i ujësjellësit "Krytha"
- Sistemi i ujësjellësit "Vlladimiri"

**Sistemi i ujësjellësit "Ulqini"**

Ky sistem furnizimi me ujë siguron furnizimin me ujë të zonës urbane, vendbanimet turistike dhe një pjesë të zonës rurale. Uji është abstraktuar nga disa burime, përkatësisht: Salç, Milla l; Milla II, Kalimani I, Kalimani II, Këllezna, Gaçi dhe Lisna Bore.

Sistemin e ujësjellësit për sa i përket pasurive të patundshme e përbëjnë:
- Objektet ujëmbledhëse,
- Dhomat ndarëse,
- Pajisjet e stacioneve pompuese dhe TS,
- Rezervuaret.
- Tubacionet.

Ujëmbledhësit e tjerë janë vendet në të cilët mblidhet uji. Në burimet: Salç, Milla I, Milla II, Kalimani I, Kalimani II uji mblidhet me ujëmbledhës, ndërsa nga burimet: Gaç, Këllezën dhe Lisën Bore uji shfrytëzohet me nxjerrjen nga puset të ujit.

**a) Ujëmbledhësi Salç**

Ujëmbledhësin e përbëjnë rrëmihja e thellë 5 m, një mur me gjatësi 8 m dhe bazeni ujëmbledhës 33 m³. Muri është prej guri, i veshur me beton i trashë 40 cm. Nënseksioni i kullimit është 1,2 x 2,1 m prej beton armesë. Baseni ujëmbledhës është prej betonit pa armaturë muret dhe pjesa e poshtme janë të trasha 30 cm. Pllaka mbuluese është me betonarme. Ujëmledhësi është ndërtuar në vitin 1933 dhe është rinovuar në 1958.

**b) Ujëmbledhësi Milla I**

Ndodhet në Millë. Ndërtesa e ujëmbledhësit është e gjatë 30 m. Gjerësia e vëllimit ësht lm, thellësia 1.5 m. Muret dhe fundi janë prej betoni të trasha 30 cm. Dhoma ujëmbledhëse është me përmasa 2.0x2.0x 2.35 m. Trashësia e pjesës së poshtme është 20 cm, muret 25 cm, dhe pllaka e mbulesës janë 15 cm. Ndërtimi është bërë prej betoni të pa përforcuar përveç pllakës mbuluese e cila është prej betoni AB. Dhoma mbyllëse është 2.5x2.0 m e gjatë dhe 2,45 m e thellë. Mbi dhomën mbyllëse është kapanxha. Vëllimi i përgjithshëm i dhomës është 22 m³. Shtëpiza e klorimit është ndërtuar me një pjesë mbi volumin e dhomës. Shtëpiza ka sipërfaqe rreth 2 m² dhe është e lartë 2.62 m. Ka dy hapësira. Ndërtimi është muraturë me kolona AB dhe rrathë. Ujëmbledhësi ësht ndërtuar në vitin 1977.

**c) Ujëmbledhësi Milla II**

Ndodhet sipër ujëmbledhësit Milla l. Ndërtesën e ujëmbledhësit e përbëjnë muri i ndërtesës me gjatësi rreth 7 m, 4 m i lartë, dhe një mur prej betoni të pa armuar 30 cm i trasha. Objekt i dhomës së grumbullimit dhe dhomës së mbylljes është me përmasa (l,6 x 3, lm) dhe 1.80 m i thellë. Muret dhe fundi

janë të trasha 20 cm, dhe një pllakë mbulesë me trashësi AB 15 cm. Vëllimi i përgjithshëm është 5.5 m³. Objekti është ndërtuar në vitin 1980.

**d) Ujëmbledhësi Kalimani I**

Gjendet në fshatin Kaliman në një lartësi mbidetare 295 m. Nërtesën e ujëmbledhësit e përbëjnë një hendek i gjatë 25 m, i gjerë 1,40 m, i thellë 3,65 m. Hendeku është i veshur me mure betoni me trashësi 20 cm. Dhoma mbledhëse në themel i ka përmasat (4,60 x 3,00 m) dhe një lartësi 3,2 m. Muret dhe dyshemeja janë punuar me beton me trashësi prej 30 cm, kurse pllaka mbuluese ka trashësi 15 cm. Vëllimi i përgjithshëm i dhomës dhe mbyllësit është 45 m³. Është ndërtuar në vitin 1980.

**dh) Ujëmbledhësi Kalimani II**

Larg nga ujëmbledhësi Kalimani I është 680 m, në një lartësi mbidetare 415 mlm. Kanali ujëmbledhës është i gjatë 9,00 m, i gjerë 1,5 m dhe i thellë 3,65 m. Dhoma me mbyllës janë me përmasa dhe konstruksion si tek Kalimani I. Ujëmbledhësi është ndërtuar në vitin 1980.

**e) Ujënxjerrësi Gaç**

Në ujënxerrësin Gaç uji nxirret përmes pusit me një seksion 2.50/2.5 m dhe thellësi 25 m. Muret e pusit janë prej betonit me trashësi 40 cm. Objekti është ndërtuar në vitin 1963.

**ë) Ujënxjerrësi Këllezën**

Në ujënxerrësin Gaç uji nxirret përmes pusit me një seksion 3.00/2.00 m dhe thellësi 8 m. Muret e pusit janë prej betonit me trashësi 40 cm. Pjesa e sipërme e mureve me larësi 1,50 m është me betonarme. Objekti është ndërtuar në vitin 1970.

**f) Ujënxjerrësi Lisën Bore**

Nxjerrja e ujit bëhet përmes 12 puseve. Dhjetë puse: BNI, BN3, BN4, BN5, BN6, BN7, BN8, BN9, BN10, BN11 i përksin sistemit të ujësjellësit Ulqin, kurse dy BN2 dhe BN12 shfrytëzohen për furnizimin me ujë të Vlladimirit. Puset BN1 deri te BN7 janë me tuba çeliku 0450 mm, me thellësi mesatare 35 m, e janë ndërtuar në vitin 1984. Puset BN – deri BN 12 janë ndërtuar në periudhën 2003 deri 2004. Këto puse janë prej tubave 0400 mm dhe me thellësi mesatare 45 m. Përjashtim bënë pusi BN 12 i cili është i thellë 28 m.

**<u>Dhomat ndarëse</u>**

**a) Dhomat ndarëse Salçi I dhe Salçi II**

**Dhoma ndarëse Salçi I** gjendet afër ujëmbledhësit. Objekti është i rrëmihur me përmasa 3.30 x 1.20 M me lartësi 1.85 m. Muret dhe dyshemeja janë prej betonit me trashësi 40 cm, kurse pullazi është në formë harku. Vëllimi i dhomësësrë cca 7,00 m³.

**Dhoma ndarëse Salçi II** gjendet më poshtë se DHN Salçi I. . Objekti është i rrëmihur me përmasa 2.00 x 2.00 x 1,20 m, përkatësisht me vëllim rreth 6 m³, kurse e mbullon pllaka nga betonarmeja. Objekti është ndërtuar në vitin 1960.

**b) Dhoma ndarëse Millë**

Dhoma ndarëse gjendet në lidhjen e tubacionit nga burimin Millë dhe Kaliman. Objekti me pjesën më të madhe është i rrëmihur dhe përmasa 9,10 x 3,40 m, lrtësi 1,80 m deri në 2,65 m. Konstruksioni është me betonarme. Muret kanë një trashësi prej 20 cm, një pjesë 15 cm, ndërsa pllaka mbuluese me trashësi 12

cm. Ndarjet në dhomë janë të trasha 10 cm, kurse lartësia 1,40 m. Vëllimi i përgjithshëm i dhomës është rreth 48 m³. Objektiështëndërtuar në vitin 1980.

**c) Dhoma ndarëse Shkallmushkë**

Gjendet në lidhjen e tubacionit i cili shkon prej PK Millë dhe tubacionit të ujënxjerrësit Këllezna. Dhoma është me vëllim njëpjesësh me vëllim 5,00 m³. Konstruksioni është prej betonarmesë. Objekti është ndërtuar në vitin 1980.

ç) **Dhoma ndarëse Fraskanjel**

Objekti ndodhet në kodrën e Fraskanjelit. Dhoma është objekt mbitokësor me përmasa 2,5 x 2,5 x 3,0 m. Muret dhe dyshemeja (fundi) janë prej betonarmesë me trashësi 20 cm, kurse pllaka mbuluese 15 cm. Vëllimi i rezervuarit është 12 m³. Objekti është ndërtuar në vitin 1984.

d) **Dhoma ndarëse Gaç**

Objekti në një pjesë është i rrëmihur. Dhoma është me vëllim njëpjesësh me vëllim 90 m³. Muret dhe dyshemeja (fundi) janë prej betonit me trashësi 20 cm, kurse pllaka mbuluese 15 cm. Objekti është ndërtuar në vitin 1963.

**Objektet e stacioneve pompuese dhe trafostacioni**

Në këto objekte bëjnë pjesë: stacionet pompuese të ndërtuara mbu puse ujënxjerrëse (janë 8 sosh) dhe impiante pompuese në zonën e qytetit të Ulqinit.

**a) Stacionet pompuese mbi puse në burimet e Lisnës e Bore dhe TS**

Stacionet e pompimit, dmth shtëpitë e puseve janë objekte identike të ndërtuara sipër puseve BNl, BN3, BN4, BN5, BN6. Objektet janë përdhese prej 12.5 m2 dhe një lartësi të dobishme prej 2.80 m. Muret janë prej betoni dhe blloqeve. Pllaka e çatisë është e sheshtë e bërë prej betoni të armuar. Dyshemeja është prej betoni, dera është prej metali.

Shtëpiza e pusit në pusin BN7, përveç shtëpisë me të njëjtat dimensione, ka një hapësirë klorifikimi prej 6.60 m2, përkatësisht sipërfaqja e përgjithshme e këtij objekti është 19.00 m2. Për nevojat e pompave është ndërtuaar edhe trafostacioni. Ndërtesa është i tipit montazh prej betonit me sipërfaqe 21m2. Ndërtesat janë ndërtuar në vititn 1984. Stacionet e pompimit të puseve BN7 deri BNll kanë dy nivele: bodrum dhe kati përdhes. Sipërfaqja e përgjithshme është 22.54 m2 Stacioni i pompimit sipër pusit BN12 është i njëjtë me atë të BNl. Stacionet e pompimit BN10 dhe BN11 u ndërtuan në vitin 2003 dhe pjesa tjetër në vitin 2004.

**b) Stacionet pompuese Këllezën, aeratori dhe TS**

Objekti ndodhet mbi ujënxherrësit të pusit në Këllezën. Në platonë e rrethuar krahas objektit të stacionit pompues gjendet edhe ndërtesa e aeratorit dhe trafostacionit.

Ndërtesa e stacionit pompues është objekt përdhes me sipërfaqe cca 70 m² dhe me lartësi të pullazit 3,00 m. Në këtë objekt janë këto përmbajtje: salla e makinerisë, impiantet komunale, seksioni për klorifikim dhe hapësirat sanitare.

Ndërtesa e aerotorit është objekt me katshmëri P+1 me sipërfaqe 192 m². Pjesa përdhese ka lartësi 2,5 m, kurse kati 4,70 m. Konstruksioni prej bartësve prej çeliku (kolonat dhe bartësit e pullazit). Mbi katin përdhes është pllakë betoni. Mbulesa e pullazit është prej asbesti. Muret janë me blloqe.

Trafostacioni ndodhet në objekt e tipit "Kullë", ka dy nivele përdhesi 2,6 m, kurse kati me lartësi 3,80

m. Sipërfaqja e përgjithshme e objektit është cca 15 m².

**c) Stacioni pompues Gaç dhe TS**

Në platonë ku janë pusat ujënxjerrës nga burimi Gaç gjenden këto objekte:

- Objekti i stacionit pompues
- Objekti i TS

Objekti i stacionit pompues është ndërtuar mbi pus. Është përdhese dhe e përbëjnë sipërfaqja e pjesës së lartë cca 40 ² dhe latrësia prej 4.00 deri 5,00 m dhe pjesa e ulët me sipërfaqe cca 23 m² lartësi 2,5 m. Konstruksioni e pjesëssë lartë është me mure masive me mbushje betoni, pullazi është i rafshtë prej betonarmesë. Objekti është ndërtuar në vitin 1963.

**Ndërtesa e stacionit pompues Qyteti**

Objekti është në zonën e qytetit të Ulqinit. Ndodhet në një lartësi prej 50 m mbi nivelin e detit. Ndërtesa përdhese ka dimensione 12.85x8.85 m. Aty ndodhen: salla e makinerive me sipërfaqe prej 35 m², impiant komandues 12.5 m2, punëtori 26,40 m2 dhe rezervuar 65 m3. Lartësia e ndërtesës është 3.3 m. Rezervuari është i rrëmihur pjesërisht, strukturat e betonit të armuar me trashësi 30 cm. Pjesa tjetër është bërë nga blloqe, me rripa dhe kolona AB. Ndërtesa është ndërtuar në 1977.

**Rezervuari Mali i bardhë**

Rezervuari ndodhet në një lartësi prej 150 m mbi nivelin e detit. Vëllimi i rezervuarit është 2000 m³. Ndërtimi është prej betonarmesë, muret janë të trasha 20 cm, dhe harku është i trashë 15 cm. Muret ndarëse në rezervuar janë gjithashtu prej betoni të përforcuar 20 cm të trashë dhe 4.00m të lartë. Dhoma mbyllëse është në bazë 3,20 x 3,80 m dhe e lartë 6,10 m. Ndërtesa është ndërtuar në 1958.

**Tubacionet**

Tubacionet e sistemit të ujësjellësit të Ulqinit përbëhen nga: tubacioni i furnizimit parësor dhe rrjeti shpërndarës sekondar dhe kyçjet. Gjatësia totale e të gjitha tubacioneve të sistemit të furnizimit me ujë është 165.678 m. Ishtë bërë nga materiale të ndryshme: çimento azbesti, çeliku, çeliku i galvanizuar, gize dhe plastike.

**a) Tubacioni kryesor i furnizimit**

Tubacioni kryesor transporton ujin nga vëllimet dhe stacioneve pompuese në rezervuarët në Mal të bardhë, stacioni i pompimit në pjesën e qytetit të Ulqinit ose në rrjetin sekondar.

Përfaqësimi sipas llojit të materialit nga të cilët janë ndërtuar tubacionet parësore jaanë si vijon: AC 71,23%, Ç23,16%, PE4% Duke shikuar sipas kapacitetitit, përkatësisht diametrit të tubave përfaqësimi është si vijon: 0250- 45,14%, 0450- 19,44%, 0600-19%. Tubacioni parësor është ndërtuar në periudhën prej vitit 1958 deri në vitin 2004.

**b) Rrjeti i shpërndarjes dhe lidhjet**

Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga rrjete të zonave urbane dhe periferike, vendbanime turistike dhe zona rurale që furnizohen nga sistemi i furnizimit me ujë të Ulqinit. Tubacionet janë bërë nga materiale dhe kapacitete të ndryshme (nga 1/2 "deri në 0450). Lidhjet nga rrjetet e shpërndarjes me konsumatorët janë bërë kryesisht nga tuba çeliku ose plastike

**Sistemi i ujësjellësit Vlladimir**

Ujësjellësi siguron furnizimin me ujë të Vlladimirit dhe fshatrave përrreth. Uji merret nga dy burime:

me një pus nga burimi në Lesen e Bore dhe nga burimi i Brajshës.

Sistemin e ujësjellësit e përbëjnë:

- Objekti i pusit ujënxjerrës BN2 në Lisën e Bore,
- Dhoma e ndërprerjes në Brajshë dhe
- Tubacioni.

**a) Ujënxjerrësi Lisën e Bore**

Uji nxirret me puset BN2 dhe BN12. Puset janë karakteristika të cilat tashmë janë dhënë te përpunimi i

këtij burimi për sistemin e ujësjellësit të Ulqinit.

Mbi puse janë ndërtuar shtëpizat në të cilat janë stacionet pompuese dhe stacioni i klorifikimit. Përmasat e objekteve janë 6,76 x 5,20 m. Struktura e mureve është me blloqe dhe rrethore horizontale.

Sipërfaqja e përdorshme e objektit mbi pusin BN2 është rreth 27 m², në të cilën janë organizuar dy hapësira me hyrje të posaçme. Sipërfaqja e përdorshme e objektit mbi pusin BN12 është rreth 12,50 m². Objektet janë ndërtuar në vitin 1984.

**b) Ujëmbledhësi në Brajshë**

Burimi ndodhet në fshatin me të njëjtin emër në një lartësi prej 182 m mbi nivelin e detit. Dhoma e grumbullimit me qepen me vëllim përafërsisht 27 m³. Muret dhe pjesa e poshtme janë prej betoni të trasha 30 cm, ndërsa pllaka e mbulesës është me betonarme 15 cm të trasha. Objekti është ndërtuar në 1984.

**<u>Tubacioni</u>**

Tubacionet e furnizimit nga burimi deri në Vladimir janë gjithashtu shpërndarës, sepse ato janë të lidhur konsumatorët nga fshatrat anësorë. Gjatësia totale e tubacionit është 20,116 m. Pjesa më e madhe e tubacionit përbëhet nga tuba të betonit të azbestit dhe pjesa tjetër janë tuba të galvanizuar prej çeliku. Tubacioni u ndërtua nga viti 1984 deri në vitin 1988. Në tubacionin u ndërtuan gjithsej 42 pusetae (valvola ajri, kullime, pikënyje).

**<u>Sistemi i ujësjellësit në Krythë</u>**

Sistemi i ujësjellësit në Krythë është i një rëndësie lokale, dmth siguron ujin për territorin e fshatit me të njëjtin emër.

Ebjektet e ujësjellësit janë:

- Objekti i ujëmbledhësit
- Tubacioni.

Objekti përfshijnë një ndërtesë ujëmbledhëse dhe një rezervuar grumbullimi. Struktura

ujëmbledhëse përbëhet nga një llogore 7.50 m e gjatë dhe 1.00 m e gjerë. Muret janë prej betoni 25 cm të trasha. Rezervuari ujëmbledhës është ndërtuat pranë kanalit. Dimensioni në bazë është 4,5x5,5m dhe thellësia 3,20m. Pranë rezervuarit është një mbyllëse me madhësi 2.3xl, 7.3.45 m. Muret dhe fundi i rezervuarit janë të trasha 25 cm, dhe pllaka e mbulesës është e trashë 15 cm. Vëllimi i mbyllëses është 68 m³. Tubacioni ka një gjatësi totale prej rreth 2519 m, nga të cilat 1400 m është bërë nga tuba të gizës 0125, dhe pjesa tjetër janë tuba PEVG 075

**<u>Objektet e instalimit hidroteknik të kanalizimit</u>**

**A) <u>Kanalizimi i fekaljeve</u>**

Kanalizimi fekal përbëhet prej dy sistemeve:

- Sistemi i kanalizimit Ulqini – qyteti
- Sistemi i kanalizimit Ulqini – Plazhi i madh

**A.1) Objektet e sistemeve kanalizuese**

**a) Stacioni pompues Ranë**

Objekti është një bazë rrethore me një diametër prej 4.10 m dhe lartësi 6.80 m. Muret dhe fundi janë me betonarme 30 mm të trasha. Në një lartësi prej 4,70 m nga kuota e fundit është ekzekutuar pllaka për mbajtjen e pompës. Kjo dhe pllaka e mbulesës janë bërë prej betonarmesë 20 cm të trasha. Pjesa e poshtme e stacionit të pompimit, kur është prej betoni të armuar. Muret janë të larta 2.2 m. Struktura është prej betoni të armuar. Ndërtesa ka një vëllim prej V = 90 m³. Objekti është ndërtuar në vitin 1988.

**b) Objekti i pajisjeve për pastrim në Pinjesh**

Objekti ka sipërfaqe cca 60 m², kati përdhes. Lartësia e ndërtesës është 3.3 m. Në objekt është vendosur rrjeti i trashë dhe i hollë. Në mes të ndërtesës është një kanal 2.5 m i gjerë dhe 60 cm i thellë. Struktura e ndërtesës është bërë nga blloqe me qarqe AB dhe një pllakë e sheshtë prej betoni. Muret janë suvatuar dhe ngjyrosur. Konstruksioni i dyshemesë është bërë me beton të armuar. Dritaret dhe dyert janë prej metali. Objekti është ndërtuar në vitin 1988.

**Objekti i pajisjeve për pastrim – Gjerana**

Ndërtesa është në formë trapezoidale, me një sipërfaqe prej afro 74 m², me një lartësi që shkon nga 2.64-3.29 m. Në mes të ndërtesës është një kanal për një rrjet të trashë dhe të imët. Thellësia e kanalit është 70 cm, dhe gjerësia 2,6 m. Konstrukti i ndërtesës përbëhet nga mure betoni 20 cm të trasha, struktura e kulmit është një pllakë AB. Ndërtesa është pjesërisht i rrëmihur në tokë. Objekti është ndërtuar në vitin 1991.

**c) Objekti i stacionit të pompimit në Gjerana**

Objekti është i llojit të pusit, me madhësi 5.5x6.40 m në bazë. Muret janë prej betoni të armuar 30 cm të trasha. Thellësia e pusit është 4.70 m. Pllaka mbulesë është prej betoni të armuar 20 cm e trasha. Vëllimi i objektit është V = 134 m³. Është ndërtuar në vitin 1991.

**Tubacioni i kanalizimit të fekaleve**

Tubacioni i kanalizimeve fekale përbëhet nga: rrjeti parësor i kanalizimeve (kolektorët), rrjeti sekondar i kanalizimeve dhe daljet nëndetëse.

Rrjeti parësor dhe dytësor u ndërtuan në periudhën nga viti 1960 deri në 2005. Ato janë ndërtuar nga materiale të ndryshme: çimento asbest, beton, qeramikë dhe PVC. Gjatësia totale e rrjetit fekal është 36077 m.

Janë ndërtuar dy shkarkime nën det:

- Shkarkimi nën Hotelin "Galeb", tubat janë PEHD035O / 3,14, me gjatësi 1500m,
- Shkarkimi në Plazhin e madh, tubat janë PEHD 0450 / 26.7 me gjatësi 1165m.

Shkarkimet nëndetëse janë bërë në vitin 1985

**Tubacioni i kanalizimeve atmosferike**

Kanalizimet atmosferike u ndërtuan nga viti 1960 deri në 1989. Tubacioni është bërë nga materiale të ndryshme. Kanalet prej betoni dhe murature janë pjesë e kanalizimeve atmosferike. Gjatësia totale e kanalit është 7603 m.

**ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE**

Analiza e situatës tregon gjendjen reale ekzistuese të UEK-ve, mbi bazën e të cilave mund të përcaktohen qëllimet dhe të merren vendime të drejta dhe në kohë, lidhur me përmirësimin e situatës aktuale.

Përmes analizës SWOT, janë përcaktuar anët e mira dhe perspektivat në afarizimin e UEK-ut - por edhe dobësitë dhe rreziqet që mbart ky biznes.

**ANËT E FORTA**

Uji është i nevojshëm nga të gjithë dhe UEK është i vetmi subjekt ekonomik përgjegjës për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të zeza në komunën e Ulqinit;

Burimet e veta të ujit;

Struktura e kënaqshme arsimore e punonjësve dhe angazhimi i stafit të UEK-ut për të realizuar punën e tyre në mënyrë efektive;

Riparimet në kohë të infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimeve, duke parandaluar kështu shkatërrimin e infrastrukturës dhe rrjeteve të mirëmbajtura në nivelin operacional;

Afarizimin e mbështesin nga disa institucione: Vodacom si konsulent, KfW Bank dhe Qeveria gjermane, e cila është e gatshme të mbështesë UEK-un me një kredi të moderuar për investime

**ANËT E DOBËTA**

Rrjeti i shpërndarjes është shumë i vjetër dhe duhet të rindërtohet;

Humbje të mëdha në rrjetin e ujësjellësit;

Lexim i vështirë i matësve të ujit tek konsumatorë të caktuar për shkak të paarritshmërisë.

Pajimi i keq - mungesa e pajisjeve;

Humbjet financiare;

Të ardhura relativisht të ulëta dhe vështirësi në pagesë;

Ulje e ndjeshme e ujit të furnizuar për konsumatorët më të mëdhenj në kategorinë e ekonomisë;

Vartësia financiare nga suksesi i sezonit turistik;

Kontrata e pafavorshme me Ujësjellësit Rajonal.

**MUNDËSITË**

Rritja e numrit të konsumatorëve;

Rritje të sasisë së ujit të faturuar dhe pagesës së kërkesave;

Mbështetje nga ministritë përkatëse të Qeverisë së Malit të Zi, Qeverisë gjermane përmes Bankës KFW për përmirësimin e mjedisit në Komunën e Ulqinit dhe mundësinë e investimit në sistemin e furnizimit me ujë dhe trajtimit të ujërave të zeza.

**KËRCËNIMET**

Situatë e vështirë ekonomike që prek aftësinë paguese të konsumatorit, rritjen e problemeve sociale dhe papunësinë;

Kostoja e lartë e Ujësjellësit Rajonal, që reflektohen në rezultatin financiar të afarizimit të UEK-ut;

Reduktuar fuqinë blerëse të institucioneve buxhetore;

Mjedisi ekonomik i paqëndrueshëm ekonomik dhe financiar.

**STRUKTURA ORGANIZATIVE**

Që nga 31 tetori 2019, në Ndërmarrjen Publike "Ujësjellëse dhe Kanalizime" Ulqin janë të punësuar

124 punëtorë.
Struktura e kualifikimit të punonjësve është dhënë në tabelën vijuese:

| Nr. | Përgatitja profesionale | Numri i punëtorëve |
|---|---|---|
| 1. | PSSH | 19 |
| 2. | SHL | 7 |
| 3. | KL | 1 |
| 4. | PMSH | 35 |
| 5. | KV | 38 |
| 6. | PK | 24 |
| | TOTALI | 124 |

Organizimi i UEK – ut është i rregulluar me Rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës.

Strukturën organizative e përbëjnë:
1. Sektori i Ujësjellës Kanalizimeve
2. Sektori për çështje ekonomike, financiare dhe juridike.

1. Në sektorin Ujësjellës dhe kanalizime kryhen punët dhe detyrat mirëmbajtjes permanente në rregull dhe
në funksion të impianteve sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit. Këtë sektor e përbëjnë tre shërbime:
1.1. Shërbimi për ujësjellës
1.2. Shërbimi për kanalizim
1.3. Shërbimi për zhvillim

2. Në sektorin e çështjeve ekonomike, financiare dhe juridike, kryhen punë financiare dhe të kontabilitetit, punë në plan dhe analiza, punë komerciale, punë juridike, punë në fushën e marrëdhënieve të punës dhe mbrojtjes në punë. Ky sektor përbëhet nga tre shërbime:
1.1. Shërbimi i çështje Financiare
1.2. Shërbimi për çështje komerciale
2.3 Shërbimi i çështjeve të Përgjithshme dhe Ligjore
2.4 Shërbimi i Mbrojtjes

## PROGRAMI I PUNËS SIPAS SEKTORËVE

## SEKTORI PËR UJËSJELLËS E KANALIZIME

**SHËRBIMI I UJËSJELLËSIT**

1. Rindërtimi - zëvendësimi i tubacioneve PE 090 dhe 0110, si dhe tubacioneve të profileve më të vogla të polietilenit në ujëmatës, për të gjithë Kalanë-Ulqin, me qëllim të zvogëlimit të humbjeve të rrjetit, tubacioneve të shkatërruara dhe furnizimit të rregullt dhe të cilësisë për konsumatorët e Stari Grad. Investitori është Qeveria e Malit të Zi.

2. Rindërtimi i tubacionit të vjetëruar prej gize 090 në vendbanimin Bratica me lidhjen e të gjithë konsumatorëve me tubave kryesor të instaluar tashmë PE09O, me qëllim të zvogëlimit të humbjeve në profilin e vjetër prej gize 090, i cili në disa vende është i futur në dhe 2.5m, me qëllim të furnizimit më cilësorë për konsumatorët e vendbanimit Braticë dhe të zvogëlimit të humjeve në rrjet, për mirëmbajtjen më të lehtë të tubacionit dhe të komplet rrjetit të ujësjellësit.
   Investitor është N.P. "Ujësjellësi e kanalizimi" Ulqin së bashku me banorët vendas të Braticës.
   Vlera e kaalkuluar e punimeve është përafërsisht 60.000,00 €.

3. Rindërtimi i dy tubacioneve të profilit të galvanizuar 02 "dhe 02.5", zëvendësim me një tubacion të ri PE 090 për zgjidhjen në Plazhin e madh afër Port Milena deri në Skelë në Plazhin e madh, me rilidhjen e të gjithë konsumatorëve me qqëllim të furnizimit më cilësor dhe të rregullt dhe zvogëlimit të humbjeve në rrjet. Vlera e vlerësuar është afërsisht 20,000.00 dhe investitor është Komuna e Ulqinit.

4. Punime të rregullta në riparimin e prishjeve si në tubacionet kryesore, si dhe në rrjetin sekondar, me qëllim të zvogëlimit të humbjeve dhe furnizimit të rregullt të konsumatorët e qytetit të Ulqinit me vendbanime periferike dhe fshatra. Sipas prishjeve në vitet e mëparshme dhe sipas parashikimit në vitin 2020, prishjet në rrjetet kryesore dhe sekondare vlerësohen të jenë rreth 650 deri 700 proporcionalisht për muaj, në varësi të konsumit, kushteve të motit dhe ndikimit të vendasve në infrastrukturën ujore (prishjet e shkaktuara veprimet e pandërgjegjshme të qytetarëve).
   Në vitin 2020 është planifikuar të vendosen tubacionet 090 dhe profile më të vogla në vendbanimin Fusha e Ulqinit për të furnizuar konsumatorët e rinj, si dhe të planifikohen tubacione të reja për ndërtimin e ardhshëm të infrastrukturës së ujësjellësit në vendbanimin Fusha e Ulqinit.
   Vlera e vlerësuar e punimeve është afërsisht 70,000.00 € dhe investitori është NP "Ujësjellësi e kanalizimi" Ulqin.

5. Monitorimi i ndërtimit të një rrjeti të ri të kanalizimeve për 4 vendbanime të reja, d.m.th. Totosh, Mali i bardhë, Kodra dhe Braticë, të gjitha me qëllim furnizimin e rregullt të konsumatorëve të vendbanimeve të përmendura. Për shkak të gërmimeve dhe shtrimit të tubacionit të kanalizimit, shpesh do të vijë deri te dëmtimi i infrastruktura e ujësjellësit dhe kanalizimeve dhe do të jetë e nevojshme që ato të riparohen menjëherë për shkak të nevojave të konsumatorëve në vendbanimet e përmendura. Meqenëse punimet do të kryhen në pjesën urbane dhe të dendur me popullsi të Komunës së Ulqinit, dhe infrastruktura është e vjetër disa dekada, nuk është e mundur të parashikohet numri dhe sasia e defekteve.

• **Stacioni i pompimit Gaç** - Riparimi i pajisjeve hidro makinave, galvanizimi i motorëve elektrikë N 55 kw, zëvendësimi i shtytësve të pompave zhytëse, zëvendësimi i injektorëve të klorit, kalibrimi i njehsorit elektromagnetik, pastrimi i pajisjeve hidro mekanike, heqja e ndryshkut, pastrimi i bojës së vjetër për përgatitjen për ngjyrosje, ngjyrimi i pjesëve fazonike të dyerëveë metalike. Funksionimi i vazhdueshëm i stacionit të pompimit dhe monitorimi i presionit në tubacion.

Vlera e investimit për këto vepra është afërsisht 6,000,00 €.
